

## RAPORT EVIDENCE

**Mbi takimin e zhvilluar me stafin e QKB-së, lidhur me angazhimet e Qendrës Kombëtare të Biznesit në planin kombëtar të veprimit për qeverisje të hapur 2026–2030 në kuadër të iniciativës për qeverisje të hapur”.**

Në kuadër të Iniciativës për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership- OGP) dhe Planit të Veprimit, Qendra Kombëtare e Biznesit ka marrë përsipër disa angazhime që lidhen me regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues dhe përditësimin e tyre nga subjektet raportuese, sipas afateve dhe kërkesave të parashikuara në ligjin “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, i ndryshuar. Konkretisht angazhimet e ndërmarra janë:

1. Sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e subjekteve raportuese mbi detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues.
2. Vlerësimin e praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Europian mbi procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues.
3. Rishikimin e legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, në kuadër të përmirësimit të procedurës së ndjekur mbi regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues.

Qendra Kombëtare e Biznesit, me qëllim diskutimin e asaj që u konkludua në takimin online datë 13.03.2026 me shoqërinë civile dhe në vijim të organizimit të ëorkshopit, datë 24-25 Mars, me EBRA (European Business Register Association), një rrjet europian që bashkon regjistrat e bizneseve dhe promovon standarde të përbashkëta për transparencën dhe shkëmbimin e të dhënave, u mbledh dhe organizoi një takim të brendshëm me stafin e saj për të dhënë një opinion apo rekomandim për angazhimet e sipërcituara.

Nga sa më sipër, duke qenë se, në punën e saj të përditshme QKB-ja ka fokus sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e subjekteve raportuese lidhur me pronarin përfitues, ky angazhim vijon të mbetet objektiv në punën e QKB-së, pasi qëllimi i ligjit 112/2020 është popullimi i regjistrit të pronarit përfitues dhe kjo arrihet duke patur sa më shumë takime, njoftime me grupet e interesit. Së dyti, duke qenë se QKB-ja, është pjesë e grupit të punës, në rrjetin europian EBRA, e cila bashkon regjistrat e pronarit përfitues nga shtete të ndryshme në Evropë, ku secili shtet, me anë të përfaqësuesit të tij, është i lirë për të folur apo ndarë praktikën e ndjekur, procedurën dhe rëndësinë që ka regjistri i pronarëve përfitues, atëherë ky angazhim do vijojë të qëndrojë, pasi informacioni i marrë në këto takime ka një efektivitet të lartë dhe vlen për t’u ndarë me shoqërinë civile. Gjithashtu angazhimi i tretë, lidhur me rishikimin e legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, është i rëndësishëm pasi jemi në proces të ndryshimit të ligjit 112/2020, i cili është tashmë i draftuar.

Në përfundim të konkluzioneve të arrira nëpërmjet diskutimit të brendshëm me stafin e QKB-së dhe faktit ku secili nga pjesëmarrësit parashitroi sugjerimet e veta, ky takim konsiderohet i mbyllur.